



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.Shk.II.nr. 273/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përbarimore të kreditorit “alfa.i” me seli në Lipjan, Rr.”Ibrahim Rugova” pn, kundër debitorit “Inter Construction Group” SH.P.K., me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Isa Salihi, avokat nga Prishtina, Bulevardi “Bill Clinton” nr.136, me bazë juridike përbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1324/22 të datës 13.12.2023, me datë **15.05.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorit “Inter Construction Group” SH.P.K., ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1324/22 të datës 13.12.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1324/22 të datës 13.12.2023, në dispozitivin e aktvendimit e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme e paraqitur nga debitori “Inter Construction Group” SH.P.K., për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr.627/21 të datës 10.11.2021, të Përbaruesit Privat Eset Murati. Ndërsa në pikën II të dispozitivit ka hedh si të pa afatshëm prapësimin e debitorit “Inter Construction Group” SH.P.K., i parashtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr.627/21 të datës 10.11.2021, të Përbaruesit Privat Eset Murati.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1324/22 të datës 13.12.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e debitorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “alfa.i” me seli në Lipjan, ka paraqitur propozim për përmbarrim në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës me numër 55-210-003-21 të datës 26.05.2021 dhe faturës me numër 202-210-003-21 të datës 05.10.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin të paguaj borxhin në lartësi prej 116,370.00 €, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarrimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, në të kundërtën realizimi i përmbarrimit të ekzekutohet përmes bllokimit të gjitha llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e mjeteve në llogarinë e kreditorit, ndërsa nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogaritë e tij bankare, zyra përmbarrimore të zbatoj përmbarrimin përmes sekuestrimit, të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori me datë 30.11.2021, ka paraqitur kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit, ndër të tjerash ka theksuar se propozimin për përmbarrim është pranuar nga punëtori i cili ishte laik dhe i cili nuk ishte i autorizuar të pranonte shkresat në emër të kompanisë dhe ky pranimi nuk është bërë nga pronari apo i autorizuari i tij , për faktin se pronari me datën 12.11.2021, ishte në udhëtim në Shqipëri dhe si pasojë e kësaj ka kaluar afati 7 ditor për paraqitjen e prapësimit, ka kërkuar nga gjykata që të aprovoj kërkesën dhe të anuloj konkluzionin me të cilin është bllokuar llogaria e debitorit dhe kjo çështje të zhvillohet konform dispozitave të LPP-së.

Debitori me datë 30.11.2021, ka paraqitur edhe mjetin juridik të prapësimit, në të cilin ka theksuar se i kundërshton në tërësi pretendimet e kreditorit, ndër të tjerash ka theksuar se konsideron se janë bërë shkelje esenciale të dispozitave procedurale të LPP-së dhe se urdhri është i pakuptueshëm dhe nuk dihet se çfarë kërkohet e po ashtu shuma e pretenduar nuk është e qartë pasi që është shumë e faturuar në mënyrë paushall pasi nuk ka të bashkangjitur asnjë kupon fiskal. Andaj i propozon Gjykatës që të aprovet në tërësi prapësimi, te hedhet poshtë urdhri përmbarrimor si dhe të detyrohet kreditori që t’i mbulojë të gjitha shpenzimet përfshirë edhe shpërblimin e avokatit sa i përket përpilimit të prapësimit.

Përmbarruesi ka ushtruar përgjigje ndaj kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, ka theksuar se debitorit urdhri për përmbarrim i është dorëzuar me datën 12.11.2021, në adresë sipas shkresave të lëndës dhe adresës së dhënë në ARBK, dhe se debitori dëshiron të vejë në lajthim gjykatën për faktin se me nenin 104.1 të LPK-së parashihet që dërgimi i shkresave personave juridik u bëhet duke iu dorëzuar shkresat personit të autorizuar për pranimin e tyre apo të punësuarit që gjendet në zyrën, gjegjësisht në lokalën e punës. I ka propozuar gjykatës që kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme të refuzohet ta refuzoj si të pa bazuar.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1324/22 të datës 13.12.2023, ku në dispozitivin e aktvendimit e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme e paraqitur

nga debitori “Inter Construction Group” SH.P.K., për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit ndaj Urdhrit Përmbarrimor P.nr.627/21 të datës 10.11.2021, të Përmbarruesit Privat Eset Murati. Ndërsa në pikën II të dispozitivit ka hedh si të pa afatshëm prapësimin e debitorit “Inter Construction Group” SH.P.K., i parashtruar ndaj Urdhrit Përmbarrimor P.nr.627/21 të datës 10.11.2021, të Përmbarruesit Privat Eset Murati.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me ndonjë shkak të arsyeshëm si rezultat i të cilit i është pamundësuar debitorit që ta ushtroj prapësimin ndaj Urdhrit Përmbarrimor P.nr.627/21 të datës 10.11.2021, ashtu që pretendimet e debitorit se urdhri është pranuar nga punëtori i cili ishte laik dhe i cili nuk ishte i autorizuar të pranonte shkresat në emër të kompanisë dhe ky pranimi nuk është bërë nga pronari apo i autorizuari i tij, nuk i mori për bazë, për faktin se përmbarruesi privat shkresat i ka dërguar në adresën e dhënë në propozim e po ashtu adresa e njëjtë është edhe në regjistrat e ARBK-së, e njëjta është pranuar nga i punësuar i debitorit siç vërtetohet nga fletë kthesa e datës 12.11.2021, andaj edhe gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e refuzuar kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme si të pa bazuar.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë nuk i ka pranuar pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave të ligjit të procedurës përmbarrimore, pasi që gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga ndërgjyqësit, ka vendosur drejtë në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin e Procedurës Kontestimore përkatësisht nenin 129 dhe nenin 104 par.1 *“Dërgimi organeve shtetërore dhe personave juridik u bëhet duke iu dorëzuar shkresat personit të autorizuar për pranimin e tyre apo të punësuarit që gjendet në zyrën gjegjësisht në lokalit e punës”*., me të cilin interpretim është pajtuar edhe gjykata e shkallës së parë sepse përmbarruesi privat shkresat i ka dërguar në adresën e dhënë në propozim e po ashtu adresa e njëjtë është edhe në regjistrat e ARBK-së, e njëjta është pranuar nga i punësuar i debitorit siç vërtetohet nga fletë kthesa e datës 12.11.2021, me të cilën është legjitime, që parashihet me nenin 104 dhe si e tillë nuk paraqet shkak për kthimin në gjendje të mëparshme, me të cilën dhomat e shkallës së dytë pajtohen në tërësi. Po ashtu me nenin 129 par.1 në të cilën thuhet se *“Në qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humbë afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humbë të drejtës që më vonë të kryejë veprimin procedural lidhur me afat, gjykata do t’i lejoje kësaj pale, me propozimin e saj, ta kryejë më vonë këtë veprim, po që se e konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshëm të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evidentohen”*.

Andaj, nga kërkesa e palës debitori gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur ta vërtetoj se kanë ekzistuar shkaqe të arsyeshme të cilën nuk kanë mundur të parashihen e as të evitohen e për të cilat ka humbur afati për paraqitje e veprimit procedural prapësimi i debitorit të përmbarrimit.

Kjo gjykatë po ashtu vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejte ka vepruar edhe kur ka vendosur lidhur me prapësimin e palës debitorë të paraqitur kundër urdhrit për përmbarrim ku nga shkresat e lëndë rezulton se Urdhri Përmbarrimor është dorëzuar tek debitori me datë 12.11.2021, ashtu që afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 13.11.2021, ndërsa debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 30.11.2021, dhe në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat e tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me njëmbëdhjetë (11) ditë vonesë.

Prandaj me këtë rast kjo gjykatë vlerëson se debitori i përmbarrimit ka rënë në vonese në paraqitjen e veprimit procedural prapësimit në këtë çështje përmbarrimore.

Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i vlerësoi të gjitha pretendimet ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitorë për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarrimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitorë eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes së përmbarrimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarrimit në këtë rast.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e shkallës së dytë,**  
**K.DH.SH.II nr.273/24 me datë 13.05.2024**

**Gjyqtari**  
**Faton Bajrami**